




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



KOMUNA E PRISHTINËS
KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të dispozitave të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 28/04, qershor 2008), të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës, merr këtë

V E N D I M

- I. Miratohet vendimi për caktimin e grupit punues për zhvillim të një databaze, e cila do të lehtësojë procesin e konsultimeve publike dhe do të ndihmojë përfshirjen më të madhe të grupeve të ndryshme qytetare e në veçanti grupet e marginalizuara në proceset vendimmarrëse në nivel lokal.
- II. Grupi punues si në pikën I të këtij Vendimi ka këtë përbërje:
 1. Gresa Deda, zyrtare për teknologji;
 2. Arlinda Kastrati, zyrtare për informim;
 3. Shkëndije Krasniqi, zyrtare e administratës;
 4. Arton Brahim, zyrtar për shërbim të kuvendit;
 5. Premtime Preniqi, koordinatorë për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore;
 6. Mentor Zeka, përfaqësues nga OSCE.
- III. Detyrë e grupit punues është krijimi i databazës si në pikën I të këtij Vendimi në bashkëpunim me organizatën Helvetas - projekti DEMOS dhe të gjitha drejtoritë e tjera brenda komunës me qëllim të identifikimit të grupeve qytetare si dhe popullimin e databazës.
- IV. Për kryerjen e detyrës si në pikën III të këtij Vendimi, grupi punues i raporton Kryetarit të Komunës.
- V. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

I D O R Ë Z O H E T:

- Grupit punues;
- Qendrës për shërbime me qytetar;
- Në dosje.

KRYETARI I KOMUNËS
Përparim Rama

